



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Shkumbin

Nr. 64/1 Prot  
Dt. 5.11.2018

VENDIM

Nr. 64/1 datë 29.10. 2018

Për

Miratimin e kërkesës për marrje leje "Miratim në parim" subjektit "Thoreneks" sh.p.k, për shfrytëzimin e përroit të Qysakut dhe të Zallit, degë e lumit Shkumbin, Bashkia Pogradec, për ndërtimin e HEC THORENEKS, për qëllime hidroenergjie.

Në mbështetje të ligjit 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" neni 5, neni 12 pika 1, neni 13 pika 2 d, neni 50 pika 2. Vendimit Nr 416 date 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumentave shoqëruse, afatit të vlefshmërisë, formularve të aplikimit për autorizime dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore". Vendimit Nr.5 datë 16.02.2016 të Këshillit Kombëtar të Ujit "Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor si dhe Vendimit Nr.6 datë 16.02.2016 të Këshillit Kombëtar të Ujit "Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor",

Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Shkumbin .

VENDOSI:

Të mos miratojë kërkesën për marrje leje "Miratim në parim" subjektit "Thoreneks" sh.p.k, për shfrytëzimin e përroit të Qysakut dhe të Zallit, degë e lumit Shkumbin, Bashkia Pogradec, për ndërtimin e HEC THORENEKS, për qëllime hidroenergjie.

*Kordinatat e marrjes së ujit (Sistemi koordinativ KRGJSH).*

**Veprat e marrjes 1**    X 53 42 15                      Y 45 29 819                      Z 1706 m m.n.d

Prurja e llogaritur                      0.062m<sup>3</sup>/sek  
Prurja mesatare                      0.040 m<sup>3</sup>/sek  
Prurja ekologjike                      0.005 m<sup>3</sup>/sek

**Veprat e marrjes 2**    X 53 43 90                      Y 45 29 200                      Z 1706 m m.n.d

Prurja e llogaritur                      0.038m<sup>3</sup>/sek

- Të respektoj grafikun e vaditjes edhe jashtë periudhës kur e kërkon Bordi i Kullimit .
- Të respektojë rrjedhjen ekologjike.
- Si dhe duke plotësuar kushtet e përcaktuara nga institucionet qendrore dhe lokale.

Ngarkohet Agjencia e Basenit Ujor Shkumbin për zbatimin e këtij vendimi.

**PËRGJEGJËS ABU**

**SHKUMBIN**

**Dashamir BICAKU**



**KRYETARI I KBU**

**SHKUMBIN**

**Maksim MALAJ**

